



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM
Nr. 226, datë 27.10.2020

PËR CAKTIM TË PËRKOSSHËM

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, mbështetur në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 59 pika 1 dhe 4, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, gërma a të Ligjit nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, dhe në Rregulloren “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve” miratuar me Vendimin nr. 64, datë 15.04.2019 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, e ndryshuar, me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës,

V E N D O S I:

1. **Znj. Afërdita Ndoi**, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, caktohet përkohësisht të ushtrojë funksionin e prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Durrës.
2. Znj. Afërdita Ndoi do të ushtrojë funksionin e prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Durrës, nga data 27.10.2020 - 26.01.2021.
3. Për periudhën e përmendur në pikën 2, Znj. Ndoi do të paguhet me pagën e pozicionit të prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Durrës.
4. Të njoftohen për këtë vendim Znj. Afërdita Ndoi, Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Durrës.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETARI
GENT IBRAHIMI

ANËTAR
KOSTAQ BELURI

ANËTAR
SANDËR BECI

ANËTAR
BUJAR SHESHI

ANËTAR
VATË STAKA

ANËTAR
ESMERALDA KESHI

ZV/KRYETAR
ALFRED BALLA

ANËTAR
NURIHAN SEITI

ANËTAR
TARTAR BAZAJ

